



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 28

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

Prishtinë, më 09 nëntor 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Enver Hoti, Flora Brovina, Haxhi Avdyli, Miljana Nikoliq, Flora Brovina, Bekim Haxhiu dhe Fikrim Damka.

Munguan: Drita Millaku, Naser Rugova dhe Time Kadrijaj.

Të ftuar: Nuk kanë marrë pjesë.

Pjesëmarrës tjerë: KDI, UNICEF dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

RENDI I DITËS:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica;**
 - Vonesat në përmbushjen e agjendës legjislative;
 - Projektionet buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2019;
 - Zbatimi i Ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës.
3. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja: Për këtë takim e kemi ftuar ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, por për shkaqe shëndetësore e ka anuluar ardhjen në mbledhje. Prandaj pasi nuk e kemi sot ministrin të pranishëm propozoj që ta plotësojmë rendin e ditës

me një pikë të re e që është Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

Gjatë mandatit të kaluar kemi monitoruar Ligjin për këshillin Ekonomiko – Social dhe kemi nxjerrë edhe disa rekomandime, ku kemi kërkuar që ky ligj të amendamentohet. Me sa e kam lexuar Projektligjin që ka ardhur, këto rekomandime janë përfshirë shumica në projektligj, megjithatë mbetet që pas miratimit në parim në Kuvend, të mund t'i bëjmë edhe ndryshimet e nevojshme.

Komisioni njëzërit u pajtua që të plotësohet rendi i ditës me piken e propozuar nga kryetarja.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social

Kryetarja, pasi u pajtuam për shqyrtimin në parim të Projektligjit, e hapi debatin.

Flora Brovina: Pajtohem që ka qenë e nevojshme që të bëhet plotësimi dhe ndryshimi i këtij Ligji duke pas parasysh edhe rekomandimet e komisionit nga mandati i kaluar.

Këshilli Ekonomiko-Social duhet të luajë rolin e njëjtë, siç e luajnë Odat e mjekëve në sektorin e mjekësisë. KES duhet t'ia japë një drejtim më ndryshe këtij sektori ku marrin pjesë edhe punëdhënësit, edhe punëmarrësit, edhe ministria. Mendoj që sindikatat duhet të jenë më të fuqishme dhe të përfaqësohen më ndryshe në këtë këshill. Pra, pajtohem që të përkrahet dhe të ecet më tutje me këtë Projektligj.

Kryetarja: E dimë që gjatë monitorimit kemi hasur në shumë vështirësi në zbatimin e këtij ligji por ato rekomandime që nuk janë përfshirë në Projektligj do t'i plotësojmë me amendamente.

Pas diskutimeve, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, me 6 vota për dhe me dy abstenim, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social

4. Të ndryshme

Haxhi Avdyli: Propozoj që në mbledhjen e radhës të ftohet Ministri i Shëndetësisë në raportim sepse agjenda e legjislacionit shëndetësor ka ngecur totalisht. Ligjet e reformës së shëndetësisë kanë qenë të parapara të vinë në qershor dhe ende nuk kanë ardhur. Në web – faqen e Ministrisë së Shëndetësië tani një vit nuk është publikuar asnjë udhëzim administrativ. E kuptoj që shëndetësia në Kosovë ka nevojë edhe për gjëra të vogla, por ka shumë çështje të rëndësishme të cilat kanë ngecur. Edhe ne, si komision, duhet të jemi më kërkuar.

Desha të ngrehet edhe një shqetësim i Institutit të Patologjisë, ku kanë ngelur shumë kufoma dhe fetus të lindur para kohe, që nuk po i merr askush dhe si mungesë e rregullimit me ligj apo me akt nënligjor, Instituti i Patologjisë nuk po ka mundësi t'i varrosë.

Kryetarja: E kemi në plan javën e ardhshme raportimin e ministrit të Shëndetësisë.

Çështja që e ngriti deputeti Haxhiu është shumë e rëndësishme dhe duhet të diskutohet me autoritetet kompetente.

Fatmire Mulhaxha – Kollçaku: Edhe unë pajtohem ta ftojme ministrin e Shëndetësisë dhe ta diskutojmë në veçanti revidimin e listës esenciale të barnave. Kërkoj edhe përkrahjen e anëtarëve të komisionit që sipas zotimit që ju kemi dhënë Klinikës së Onkologjisë t'i përkrahim kërkesat e tyre dhe tani që Projektligji i buxhetit për vitin 2019, është proceduar në Kuvend, këto kërkesa të përfshihen. Ne i morëm kërkesat e tyre për dy aparate të reja për kimio dhe radio terapi pasi aparatet ekzistuese janë të vjetra më shumë se 15 vjet.

Gjithashtu nga ministri i Punës të kërkojmë që për pacientët që marrin kimioterapi, në ligjin e ri të punës të përfshihet periudha e pushimit me pagesë gjatë kohës sa marrin kimioterapi që është shumë e domosdoshme për këta pacientë. Edhe për këtë çështje kërkoj përkrahjen e anëtarëve të komisionit.

Kryetarja: Ne të gjithë ishim prezent në vizitën në Klinikën e Onkologjisë, dhe të gjithë e dhamë mbështetjen për kërkesat e Klinikës së Onkologjisë dhe nuk ka nevojë që nga ti të na kërkohet kjo mbështetje, por esenciale është që ne të marrim përkrahje nga Kuvendi që këto kërkesa të përfshihen në buxhetin e vitit 2019.

Fatmire Mulhaxha Kollçaku- Kuvendi ka miratuar shumë rezolutive deklarative dhe kanë dhënë shumë premtime që nuk janë realizuar, prapë ju bëj thirrje që kjo çështje të ngritet përsëri dhe të përkrahet.

Kryetarja: Të gjitha vendimet i kemi marrë së bashku, edhe rendin e ditës edhe kë do ta ftojme apo kë do ta vizitojmë i kemi vendosur së bashku. Prandaj kërkoj që debatet e seancës të mos barten në komision. Ata që duan debat mos t'i ikin debatit në seancë, e ta bartin debatin politik në komision, këtu jemi për të punuar në amendamentim të ligjeve.

Flora Brovina: Të gjithë u dhamë përkrahje kërkesave të Klinikës së Onkologjisë, por disa deputet të komisioni e shfrytëzuan këtë takim për propagandë personale. Mos e keqpërdorni komisionin dhe vizitat e tij për konferenca të partive.

Enver Hoti: Falënderoj drejtorin e Onkologjisë që na njoftoi me punën e Klinikës së Onkologjisë dhe të gjithë i mbështetëm kërkesat e tyre. Nuk pajtohem me deputetin Haxhi Avdyli që tha se komisioni po dështon në kryerjen e detyrave të tij. Komisioni nuk po dështon dhe po kryen detyrat me përgjegjësi, por po kemi vonesa në procedimin e Projektligjeve nga Qeveria, por edhe ne, si deputetë, mund të marrim iniciativa për ndryshimin e Projektligjeve.

Projektligji për buxhetin e vitit 2019 ka ardhur dhe ne mund të bëjmë amendamente që t'i përkrahim kërkesat e Klinikës së Onkologjisë. Akuzat e koleges Fatmire janë të pa mbështetura.

Haxhi Avdyli: Ne jemi në Parlament dhe mund të ngrehim çështje ashtu si ne mendojmë dhe nuk mund të na ndalojë askush. Prapë mendoj që nuk jemi komision aktiv dhe duhet të jemi më kërkues. Ministria e Shëndetësisë gjatë këtij viti ka sjellë vetëm një ligj. Tryeza e organizuar për kancerin ka qenë në nivel të partive nuk ka pasur të bëjë asgjë me komisionin.

Enver Hoti: Tha se retoriken zhurmuese të Kuvendit të mos e bartim në komision, sepse këtu duhet të punohet më shumë, e politikë të bëjmë më shumë në seancë.

Flora Brovina: Nuk më ka pëlqyer mënyra se si dy kolegët tanë, menjëherë pas vizitës në Onkologji, kanë organizuar konferencë për shtyp dhe e kanë keqpërdorë vizitën e komisionit për përfitime politike.

Kryetarja: Dua të sqarohem se nuk po them të mos ngritën çështjet, por mos të kërkohet nga ne të ju mbështesim në kërkesat e Klinikës së Onkologjisë, kur të gjithë kemi qenë së bashku në vizitë dhe të gjithë njëzërit t i kemi përkrahur ato kërkesa. Nga diskutimi juaj po del që ne nuk po ju mbështesim. Ne të gjithë i kemi mbështetur kërkesat e Onkologjisë.

Bekim Haxhiu: Shpresoj që si komision do të punojmë bashkë në monitorimin e ministrive përgjegjëse dhe në amendamentimin e Projektligjeve. Këtë vit Projektligje të proceduara nga dy ministrat kemi pasur pak. Ka nevojë të procedohen sa më shpejt ligjet e reformës në shëndetësi, por edhe ligji i reformës së sistemit pensional. Te ftesat e ministrave duhet të kërkohet nga ministri i punës pse janë ndalur pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe gjithashtu të sqarohemi a janë duke na sjellë ligjin e reformës së sistemit pensional, apo ne ta marrim iniciativën e ndryshimit të Ligjit për skemat pensionale të financuara prej shtetit, sepse ka shumë kërkesa nga ata të cilët nuk po mund t'i arrijnë me 15 vjet përvojë pune.

Nga ministri i Shëndetësisë të kërkohet një raport në komision për procesin e revidimit të listës esenciale të barnave dhe a janë përfshirë në këtë listë barnat e sëmundjeve të rralla.

Po e jap edhe një sugjerim që nuk është mirë me bë politik me sëmundjet e rënda të pacientëve.

Flora Brovina: Në Kuvend u bë një debat për shtesat e fëmijëve, por nuk më pëlqeu se si rrodhi debati sepse shtesat e fëmijëve nuk janë shtesa sociale, por janë shtesa për fëmijët dhe duhet të gjithë fëmijët të jenë të barabartë.

Kryetarja: Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU